



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

NJOHJEN E KREDITEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL NË VAZHDIMËSI

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 216, datë 31.10.2018

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore synon të përcaktojë kriteret dhe procedurën që ndiqen për vlerësimin e krediteve, me qëllim njohjen e tyre si kredite të vlefshme të formimit profesional në vazhdimësi për profesionet që licencohen/miratohe nga Autoriteti.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 14, nenit 20 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 38 të Rregullores nr. 130, datë 31.08.2017 “Për organizimin dhe përshkrimin e detyrave”.

Neni 3

Fusha e Zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për:

1. Personat fizikë, të cilët kërkojnë të licencohen/miratohe nga Autoriteti si anëtarë të organeve drejtuese të personave juridikë që licencohen nga Autoriteti;
2. Personat fizikë, të cilët kërkojnë të licencohen/miratohe nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari në profesione që licencohen nga Autoriteti;

3. Personat fizikë, të cilët kërkojnë të rinovojnë licencën/miratimin e Autoritetit për të ushtruar veprimtari në profesione që licencohen nga Autoriteti.

Neni 4 **Përkufizime**

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a. “Kualifikim profesional” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti profesional, i cili mund të përfitohet nëpërmjet mësimnxënies. Termi “Kualifikim profesional përfshin “Kualifikim profesional bazë” dhe “Kualifikim profesional në vazhdimësi”;
 - b. “Kualifikim profesional bazë” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash profesionale, të përfutuara me anë të së cilave personi vërteton aftësinë për të ushtruar një aktivitet profesional të licencuar/miratuar nga Autoriteti;
 - c. “Kualifikim profesional në vazhdimësi” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash profesionale, të përfutuara në aktivitete të formimit profesional gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës/miratimit dhe me anë të së cilave personi vërteton përditësimin dhe zgjerimin e njohurive e aftësive profesionale, të nevojshme për të rinovuar të drejtën për të ushtruar një aktivitet profesional të licencuar/miratuar nga Autoriteti;
 - d. “Program i kualifikimit profesional në vazhdimësi” është sistemi i bazuar në cikle periodike, që përputhet me periudhën e vlefshmërisë së një licence/miratimi të dhënë nga Autoriteti, brenda të cilit personi duhet të plotësojnë një numër minimal të domosdoshëm krediteve të vlefshme, me qëllim që të vërtetojë përditësimin dhe zgjerimin e njohurive e aftësive profesionale, për të rinovuar të drejtën për të ushtruar aktivitetin profesional. Niveli i krediteve minimale, të vlefshme për një cikël të programit të kualifikimit profesional në vazhdimësi, sipas profesioneve që licencohen, miratohen nga Autoriteti e përcaktohen në aneksin 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
 - e. “Kredit” është njësia që përdoret për të përcaktuar masën e ndjekjes së aktivitetit të konsideruar të përshtatshëm për vlerësimin e formimit profesional në vazhdimësi.

Neni 5 **Të përgjithshme**

1. Njohja e krediteve të vlefshme të formimit profesional në vazhdimësi kryhet duke vlerësuar përshtatshmërinë e programit të aktivitetit të kryer, me profilin e punës dhe profesionit të personit të interesuar.
2. Lista e aktiviteteve të përshtatshme për njohjen e krediteve të cilat janë kryer në organizma të ndryshëm nga Autoriteti, përcaktohet në aneksin 3 të kësaj rregullore.
3. Numri i krediteve llogaritet në bazë të kriterit $60 \text{ min} = 1 \text{ kredit}$.
4. Numri i krediteve të përfutuara gjatë aktiviteteve të cilat janë kryer në organizma të ndryshëm nga Autoriteti, llogariten në bazë të kohës së angazhuar në mënyrë aktive në

përmbajtjen e edukimit në vazhdim. Koha e kaluar në bashkëbisedime, gjatë ngrënies ose në pushimet përgjatë aktiviteteve nuk konsiderohen kredite të vlefshme.

5. Kreditet e përftuara nga pjesëmarrja në aktivitete me tema të përgjithshme që nuk lidhen specifikisht me ushtrimin e profesionit nuk konsiderohen të vlefshme.
6. Autoriteti, me kërkesë të personit të interesuar, në përfundim të secilit cikël të formimit profesional në vazhdimësi lëshon dëshmi për të gjitha aktivitetet ku profesionisti ka marrë pjesë dhe kreditet e vlefshme të njohura nga Autoriteti.

Neni 6

Aplikimi për njohje të krediteve

1. Procesi i njohjes së krediteve të vlefshme të formimit profesional në vazhdimësi fillon me aplikimin e personit të interesuar për njohjen e krediteve të përftuara. Aplikimi depozitohet brenda 60 ditëve nga data e përfundimit të aktivitetit.
2. Mënyrat e aplikimit për njohjen e krediteve të formimit profesional në vazhdimësi janë:
 - a. Aplikim shkresor në zyrën e protokollit të Autoritetit;
 - b. Aplikim elektronik në postën elektronike të Autoritetit amf@amf.gov.al.
3. Aplikimi për njohje të krediteve duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Formularin e aplikimit të përcaktuar në aneksin 1 të kësaj rregullore, i cili publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit;
 - b. Vërtetim apo dokument tjetër të barazvlefshëm që vërteton kryerjen e trajnimit;
 - c. Programin e trajnimit të kryer;
 - d. Materiale të përftuara (në rrugë elektronike apo hard copy) në aktivitet (kur është e aplikueshme);
 - e. Kopje të kartës së identitetit apo pasaportës.

Neni 7

Vlerësimi dhe njohja e krediteve

1. Pas depozitimit të kërkesës së shoqëruar me dokumentacionin e plotë sipas nenit 6 të kësaj rregullore, Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore verifikon saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të depozituar, si dhe të dhënave të raportuara në formularin e aplikimit.
2. Nëse dokumentacioni apo të dhënat e depozituara nuk janë të plota, Autoriteti njofton aplikantin për plotësim të dokumentacionit/të dhënave, brenda 8 ditëve pune nga data e depozitimit të formularit të aplikimit. Plotësimi i dokumentacionit të kërkuar bëhet brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të Autoritetit.
3. Procesi i vlerësimit dhe njohjes së krediteve vijon vetëm për në rastet kur aplikimi dhe dokumentacioni përkatës janë depozituar sipas kërkesave të nenit 6 të kësaj rregullore.
4. Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore, kryen rolin e sekretariatit teknik dhe përgatit dosjen e plotë të aplikantit të shoqëruar me një informacion përmbledhës të cilin ia përcjell për shqyrtim dhe vendimmarrje Komisionit të Vlerësimit e Njohjes së Krediteve.

5. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv krijon Komisionin e Vlerësimit e Njohjes së Krediteve i cili përbëhet nga Drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes Konsumatore, Drejtori i Mbikëqyrjes së Tregut përkatës ku aplikanti ushtron veprimtarinë, Drejtori i Drejtorisë së Zbatueshmërisë.
6. Komisioni i Vlerësimit e Njohjes së Krediteve, nëpërmjet Drejtorisë së Mbrojtjes Konsumatore, mund të kërkojë informacione shtesë të nevojshme për vlerësimin dhe njohjen e krediteve.
7. Pas shqyrtimit të dosjes, Komisioni i Vlerësimit dhe Njohjes së Krediteve vendos për njohjen e krediteve ose mund të kthejë dosjen për plotësim.
8. Drejtorja e Mbrojtjes Konsumatore, në bazë të vendimit të Komisionit kryen rregjistrimin e krediteve të njohura të vlefshme në regjistrin e krediteve, si dhe përgatit vërtetimin për njohjen e krediteve për çdo aplikant. Në rast të mosnjohjes së krediteve përgatit përgjigjen përkatës për aplikantin.
9. Procedura për njohjen e krediteve të formimit profesional në vazhdimësi për profesionet që licencohen/miratohen nga Autoriteti kryhet nga Autoriteti brenda 30 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës të shoqëruar me dokumentacionin e plotë sipas kësaj rregulloreje.

Neni 8

Regjistri i krediteve

Autoriteti krijon regjistrin e krediteve i cili përmban të dhënat për kualifikimet profesionale për personat që licencohen/miratohen nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari në profesione në tregjet nën mbikëqyrje të Autoritetit.

Ky regjistër përmban të dhëna personale dhe profesionale për të gjithë individët të cilët kanë aplikuar në Autoritet për njohjen e krediteve të përfuara në trajnime të cilat janë kryer në organizma të ndryshëm nga Autoriteti. Regjistri i krediteve administrohet nga Drejtorja e Mbrojtjes Konsumatore.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Aneks 1

FORMULAR APLIKIMI PËR NJOHJEN E KREDITEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL NË VAZHDIMËSI

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: E-mail: amf@amf.gov.al Web: www.amf.gov.al	Hapësirë e Rezervuar për institucionin Data e depozitimit në AMF Mënyra e depozitimit: <input type="checkbox"/> Me shkrim në zyrën e protokollit të AMF-së; <input type="checkbox"/> Me postë elektronike në adresën amf@amf.gov.al		
<i>Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar</i>			
SEKSIONI A¹: INFORMACION MBI APLIKANTIN			
Emri Mbiemri			
NID Nr. Personal i Identifikimit			
Profesioni (lloji i profesionit të licencuar miratuar nga AMF)			
Të dhëna të licencës	Nr. i licencës	Data e lëshimit të licencës	Data e përfundimit të licencës
Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull		<input type="checkbox"/> Femër
Datëlindja	Data/Muaji/Viti		
E-mail			
Telefon			
Adresa			
SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN			
Njohje të krediteve për programin:	<input type="checkbox"/> Trajnim <input type="checkbox"/> Konferencë <input type="checkbox"/> Kurs kualifikimi <input type="checkbox"/> Seminar <input type="checkbox"/> Workshop		
Kohëzgjatja e aktivitetit	Datë fillimi	Datë përfundimi	
Titulli i programit të aktivitetit të kryer			

¹ AMF informon se të dhënat personale të deklaruara në këtë formular aplikimi do të ruhen, trajtohen, përpunohen dhe transferohen në përputhje me Ligjin 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". AMF i konsideron dhe i trajton të dhënat Tuaja personale si konfidenciale. AMF i ruan të dhënat Tuaja me të njëjtin nivel sigurie që i ofrohet çdo të dhënë tjetër konfidenciale dhe do të kufizojë përdorimin e tyre vetëm për qëllimin për të cilat ato janë dhënë.

Organizmi që ka organizuar/zhvilluar aktivitetin	
Kontaktet zyrtare të organizmit që ka organizuar/zhvilluar aktivitetin	Adresa:
	E-mail
	Telefon
Numri i përafërt i pjesëmarrësve në aktivitet	
Profili i punës së pjesëmarrësve në aktivitet (rregullatorë, operatorë të tregjeve, institucione të qeverisjes)	
Përshkruaj çështjet kryesore të trajtuara në aktivitet	
Përshkruaj çështjet më të vlefshme të përfuara gjatë aktivitetit dhe si do të përdorni aftësitë e përfuara	

Deklaratë:

Të dhënat e deklaruara në këtë formular aplikimi janë të vërteta dhe i jepen Autoritetit për ti administruar me qëllim shqyrtimin e kërkesës time për njohje të krediteve të formimit profesional në vazhdimësi. Aplikuesi: Emër

Mbiemër _____

Aneks 2

Kreditet minimale të vlefshme për një cikël të programit të kualifikimit profesional në vazhdimësi sipas profesioneve

Profesioni	Cikli i programit të kualifikimit profesional në vazhdimësi	Kreditet minimale të vlefshme
Agjent në sigurime	3 vjet	18
Aktuar	3 vjet	40
Broker në sigurime	3 vjet	24
Vlerësues dëmsh në sigurime	5 vjet	24

Aneks 3

Lista e aktiviteteve të formimit profesional të përshtatshme për njohjen e krediteve të cilat janë kryer në organizma të ndryshëm nga Autoriteti

Emërtimi i aktivitetit	Kuptimi
Trajnimi	Aktivitet mësimor në grup, që zhvillohet nga Autoriteti (10-25 vetë), me orientim të theksuar drejt praktikës profesionale, që gërsheton dhënien e leksioneve me metoda të tjera pedagogjike. Qëllimi është që pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri, aftësi/shprehi ose kompetenca që u nevojiten për të përmbushur ushtrimin e profesionit në mënyrë të kënaqshme.
Kurs kualifikimi	Program i plotë trajnimi me kohëzgjatje më shumë se tre muaj që synon aftësimin e pjesëmarrësve në një fushë specifike të lidhur drejtpërdrejt me shërbimin që ata aktualisht kryejnë ose që dëshirojnë të kryejnë. Zhvillohet kryesisht me ose pa shkëputje nga puna. Zakonisht, është pjesë e programeve pasuniversitare.
Konferencë	Aktivitet 1-2 ditor që mbahet mbi një temë të caktuar, zakonisht e ofruar nga shoqata profesionistësh, rregullatorë apo organizma të njohur ndërkombëtar, ku ekspertë të fushës prezantojnë leksione ose studime të reja. Organizohet në seanca plenare dhe/ose seanca paralele apo workshope. Qëllimi i konferencës është të informojë audiencën profesionale mbi të rejat e shkencës, teknologjisë ose standardet e normat e reja në lidhje me profesionin në fjalë.
Seminar	Formë akademike e të mësuarit që përdoret edhe si aktivitet i formimit profesional në vazhdimësi. Gjatë seminarit një grup pjesëmarrësish prej 5-30 vetësh mësojnë rreth një çështjeje të caktuar duke marrë pjesë aktivisht në debat. Në një seminar diskutohen

	<p>artikuj të caktuar, prezantohen studime të ndryshme, bëhen pyetje dhe debate në mënyrë sa më pak formale.</p>
<p>Workshop</p>	<p>Aktivitet më vete ose një metodë e përdorur brenda një aktiviteti tjetër. Është një aktivitet i një grupi të vogël (4-15 vetë), me orientim drejt zgjidhjes së problemeve ku pjesëmarrësit përfshihen aktivisht në diskutime ose në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi, të ndihmuar nga eksperti/trajneri. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë duke provuar, gabuar dhe vetëkorrigjuar ose duke u korrigjuar me ndihmën e të tjerëve.</p>